



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501852/7

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Kërkesë për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Kryetarit të Zyrës së Përmbartimit Fier z. Arjan Çepele.*

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor
Z. Albert PILO

Tiranë

Për dijeni : Ministrit të Drejtësisë
Z. Ylli MANJANI

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesë shtetësja Zh.P. me banim në fshatin Seman, Fier. Ankuesja shkruan se, me vendimin nr. 1559, datë 18.10.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është bërë zgjidhja e martesës së saj me shtetasin A.M.. Sipas këtij vendimi, dy fëmijët e tyre, V.M. 16 vjeç dhe V.M. 15 vjeçe, i janë lënë për rritje dhe edukim ankueses Zh.P.. Ndërsa ish bashkëshorti i saj, shtetasi A.M., duhet të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën V.M. në masën 8000 lekë në muaj dhe për fëmijën V.M. 7000 lekë në muaj. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 22.11.2011 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 1039, datë 30.11.2011 ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të tij.

Ankuesja shkruan se, meqënëse ish bashkëshorti i saj nuk po zbatonte vendimin gjyqësor lidhur me pagimin e detyrimit ushqimor ndaj dy fëmijëve të tyre, ajo i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Përmbartimit Fier. Ajo pretendon se, megjithëse u bënë disa vjet që i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit, por kjo zyrë nuk ka bërë të mundur ekzekutimin e vendimit gjyqësor të cituar më lart.

Gjithashtu ajo shkruan se, për shkak të dhunës së ushtruar nga ish bashkëshorti edhe pas zgjidhjes së martesës së tyre, ndaj saj dhe të dy fëmijëve V.M. dhe V.M., nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është dhënë për disa vjet rresht urdhër mbrojtjeje. Urdhri i fundit i mbrojtjes është lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 68, datë 15.06.2015.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *"Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme"*, me shkresën nr. K2/Zh5-2 Prot., datë 14.10.2015, i kërkuam Kryetarit të Përmbarrimit Fier që të verifikonte këtë rast dhe të na dërgonte shpjegime rreth pretendimeve të ngritura nga ankuesja.

Bashkë me informacionin i kërkuam të dërgonte edhe fotokopje të akteve që janë bërë nga kjo zyrë në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor.

Me shkresën nr. 108 Prot., datë 16.10.2015, z. Çepele na informoi se, nga Zyra e Përmbarrimit Fier janë kryer veprimet procedurale në bazë të nenit 510 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, por nuk është zbatuar vendimi i gjykatës dhe urdhri i përmbarruesit gjyqësor. Gjithashtu në këtë shkresë ai shprehej se, rasti ka të bëjë me pension ushqimor dhe është me afat të gjatë zbatimi. Për këto arsye përmbarruesi gjyqësor kërkon edhe bashkëpunimin e palës kreditore për ta informuar nëse debitori është në marrëdhënie pune, ose nëse ai ka pasuri të sekuestrueshme nga ligji.

Lidhur me këtë përgjigje kontatuam se:

Së pari, z. Çepele nuk na informoi lidhur me veprimet procedurale të bëra nga kjo zyrë dhe nuk na dërgoi fotokopje të akteve që janë bërë prej saj lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor.

Së dyti, fakti që objekti i vendimit është pensioni ushqimor kërkon veprime të shpejta të zyrës së përmbarrimit, sepse fëmijët e palëve kanë nevoja të shumta për rritje dhe edukim.

Së treti, fakti që ky lloj objekti është me afat të gjatë nuk do të thotë që zbatimi i tij të zvarritet apo të moszbatohet kurrë.

Së katërti, nga ana jonë u komunikua me ankuesen (kreditoren) në lidhje me problemin e bashkëpunimit të saj me përmbarruesin gjyqësor. Ajo na informoi se, i ka dhënë informacione përmbarruesit gjyqësor lidhur me pasuritë e debitorit. Sipas ankuses, debitori A.M. ka prona të paluajtshme dhe i ka në bashkëpronësi me prindërit e tij dhe konkretisht tokë bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", banesë dhe truall rreth saj, një truall pranë Manastirit, të cilat ndodhen në fshatin Pojan të qytetit Fier. Këto prona janë të regjistruara në ZVRPP Fier në emër të babait të debitorit, shtetasit K.M..

Me shkresën nr. K2/ZH5-5 Prot., datë 02.11.2015, drejtuar z. Çepele, i parashtruar konstatimet e cituara më sipër dhe i kërkuam që të na dërgonte informacion shtesë, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së kësaj shkrese, lidhur me veprimet konkrete dhe aktet procedurale që janë bërë nga Zyra e Përmbarrimit Fier për të bërë të mundur vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e debitorit me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të kreditorës Zh.P..

Ndonëse afati ligjor i caktuar më lart kaloi, ai nuk na dërgoi informacionin dhe aktet procedurale të kërkuara nga ana jonë. Mosdërgimi i informacionit dhe të dokumentave të kërkuara ka sjellë vonesë në shqyrtimin e këtij rasti dhe moskorrektesën tonë ndaj ankueses.

Ndërkohë me shkresën nr. K2/ZH5-6 Prot., datë 26.11.2015, i përsëritën kërkesën për dërgimin e informacionit të kërkuar, brenda 5 ditëve nga data e mbërritjes së shkresës tonë.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj shkrese i kujtuam atij se, detyrimi i organeve të administratës publike për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit dhe për t'i kthyer përgjigje kërkesave të tij është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Gjithashtu i bëmë të ditur se ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në nenin 22/1 të tij parashikon edhe të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar masa disiplinore ndaj punonjësve të administratës publike të cilët nuk bashkëpunojnë me të.

Megjithatë, edhe pas kërkesës tonë së dytë, ai përsëri nuk na e dërgoi përgjigjen e kërkuar nga ana jonë.

Moskthimi i përgjigjeve të kërkuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të një funksionari të administratës publike me institucionin tonë.

Ky qëndrim i Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Fier me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankueses. Ndërkohë kjo sjellje, cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit "Për Avokatin e Popullit" ku parashikohet se: *"Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil"*,

KËRKOJMË:

1. Fillimin e procedurës administrative (ecurisë disiplinore) dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Fier z. Arjan Çepele.

2. Ky rast të përgjithësohet dhe t'u bëhet i njohur gjithë drejtuesve Zyrave të Përmbarrimit në vend me qëllim që sjellje të tilla të mospërsëritet më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe fotokopje të shkresave tona dërguar Kryetarit të Zyrës së Përmbartimit Fier, respektivisht me nr. K2/Zh5-2 Prot., datë 14.10.2015; nr. K2/ZH5-5 Prot., datë 02.11.2015; dhe nr. K2/ZH5-6 Prot., datë 26.11.2015.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT
NË MUNGESË DHE ME POROSI**

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI